
ILUMINIZMI NË SISTEMIN KULTUROR E LETRAR SHQIPTAR ENLIGHTENMENT IN THE ALBANIAN CULTURAL AND LITERARY SYSTEM

KRISTAQ JORGO

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë
Email: kristjorgo@yahoo.com

AKTET VI, 4: 375 - 379, 2013

PËRMBLEDHJE

Do të përpiqemi të parashtrojmë në këtë artikull pikat kyçe të hipotezës sonë të punës në themel të së cilës qëndron përpjekja për ta identifikuar fenomenin e Iluminizmit në hapësirën gjeo-g-ra-fi-ke e kulturore shqiptare në të gjithë shtrirjet dhe kompleksitetin e vet. Thelbi i kësaj hipoteze mund të formulohet kështu: rrymat filozofiko-kulturore janë imperative, moment të qenies ko-le-k-ti-ve të cilat duhet t'i përfshijë entiteti kolektiv. Sinkroniciteti ndërkombëtar e bën të pa-sh-ma-n-g-shëm shfaqjen e dukurive analoge në areale të ndryshëm etno-socio-kulturorë, ashtu siç e shtrin to-talitetin e veprimit, të potencialit e të aksionit të rrymës përkatëse në të gjithë segmentin kohor në të cilin entiteti i dhënë përmbush, realizon hapat evolutivë të ecurisë dhe të rritjes së tij konkrete. Për ta formuluar më shkurt e me të tjera fjalë: potenciali i plotë manifestohet diakronikisht në përputhje me hipotazat/fazat e rritjes që përjeton entiteti i dhënë socio-kulturor.

Fjalë çelës: Iluminizëm, sistem letrar, sistem kulturor, sinkronicitet, teori e polisistemit

Key words: Enlightenment, literary system, cultural system, sincronicity, polysystem theory.

Hyrje

Mund të thuhet se ekziston një 'querelle' e he-shtur në mendimin kulturologjik e letrar shqiptar sa i përket fenomenit të Les Lumieres, e cila do të mund të emërtohej "querelle midis minimalistëve dhe maksimalistëve". Do të mund ta qartësonim këtë përmes citimit e pastaj komentimit të zërit 'Iluminizmi' të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:

"Iluminizmi": Rrymë ideore e përhapur në Euro-pën Perëndimore në shekujt XVII e XVIII, e cila zhillimin dhe përparimin e shoqërisë e lidhte me zhvillimin e përhapjen e arsimit e të shkencës, në luftë me obskurantizmin mesjetar. Iluminizmi në Shqipëri lindi në gjysmën e dytë të shek. XIX. Ai ishte karakteristik për ideologjinë e Rilindjes Kombëtare dhe të përfaqësuesve të saj më të shquar: N. Veqilharxhi, P. Vasa, J. Vreto, N. Frashëri, S. Frashëri. Përpjekjet për përhapjen e arsimit dhe të diturisë, si kusht i përparimit dhe i

qytetërimit shoqëror, ata i lidhën me kërkesën për shkrimin e gjuhës shqipe e hapjen e shkollave shqipe. Luftën për shkrimin e gjuhës shqipe dhe hapjen e shkollave kombëtare, rilindësit e bashkuan me luftën kundër pushtimit osman dhe intrigave e synimeve të qarqeve shoviniste të vendeve fqinje. Për këtë iluminizmi i tyre mori përmbajtje patriotike dhe përparimtare. Lufta për shkrimin e gjuhës shqipe, për hapjen e shkollave kombëtare, për përhapjen e diturisë pati martirët e saj si: N. Veqilharxhi, Papa K. Negovani, P. N. Luarasi etj." (Fjalori: 342).

I.

Kemi këtu, mund të thuhet, në trajtë të përmbledhur, pikëpamjen e emërtuar prej nesh 'minimaliste'. Le të vërejmë: iluminizmi cilësohet rrymë ideore; në Shqipëri ai 'lind' në gjysmën e dytë të shek. XIX, është pjesë përbërëse vetëm e ideologjisë së Rilindjes Kombëtare dhe asgjë

përveç kësaj, ka më shumë lidhje me aksionin kulturor e politik se sa me praktikën shkrimore. Nuk përmendet termi 'letërsi', shpërfillet fakti se nuk kemi ende 'Shqipëri' në kuptimin politik e administrative të termit, respektivisht nuk bëhet fjalë për mundësinë e gjurmëve të Iluminizmit në një periudhë të mëhershme të historisë, po ashtu shpërfillet apo lihet në heshtje mundësia e kontaktit me idetë e lëvizjen iluministe të individëve albanofonë që jetojnë e veprojnë në hapësira gjuhësore e kulturore të huaja; iluminizmi shqiptar lidhet ekskluzivisht me gjuhën shqipe; nuk ceket çështja e ndikimit të tij apo e receptimit të ideve e veprave të Iluminizmit në etapat e mëtejshme të evolucionit të entitetit kolektiv shqiptar e të kulturës së tij.

Pikëpamja 'maksimaliste' jo se e mbush shumicën e këtyre boshllëqeve, por ajo e zgjeron në kohë dhe hapësirë hartën shqiptare të Iluminizmit duke e bërë atë thujse bashkëkohës me fenomenin në vatrat lindëse të tij (Angli e Francë) në shembullin e lëvizjes kulturore e diturore përreth Akademisë së Re të Voskopojës e të traditës që ajo krijoi. Gjithashtu duke përfshirë në qarkun e Iluminizmit shqiptar aksionin dhe produktin krijues të frymës iluministe (të modelit illuminist) të individëve apo të rretheve shqiptare që veprojnë në kuadër të hapësirave gjuhësore e kulturore jo shqiptare ose në ato jo kryesisht të tilla (Stamboll, Napoli, Sicili), apo që kanë kontakt me lëvizjen e Iluminizmit, me letërsinë e me përfaqësuesit e saj në qendrat kryesore të Evropës të shek. XVIII.

Një pajtim apo afrim mes këtyre pikëpamjeve do të ishte i mundur vetëm nëse kuadri metodologjik i studimit do të pasurohej me konceptet e identitetit etnogjuhësor jo domosdoshmërisht unitar, por plural e të lëvizshëm si dhe të funksionit jo domosdoshmërisht univok të aksionit politik e kulturor të individëve të këtyre hapësirave; me konceptin e natyrës plurale (në vështrimin etnik, gjuhësor, kulturor e politik) të hapësirës në të cilën jeton, shkollohet, vepron e krijon individi shqiptar, si dhe të natyrës po ashtu jo unitare nga pikëvështrimi gjuhësor dhe etnik të arealit shqiptar, le të themi, të mirëfilltë/ në kuptimin e ngushtë të termit).

II.

Në studimet mbi raportin e Iluminizmit me lëvizjen shqiptare të Rilindjes Kombëtare nënvizohet roli gjithmonë i drejtpërdrejtë, maksimalisht pozitiv dhe jashtëzakonisht frymëzues e nxitës i të parëve (les Lumières) mbi të dytën. Asnjëherë nuk është vënë në pah raportin konfliktual i ideve të Rilindjes me rryma të tjera të mendimit, bashkëkohëse e vijuese të tyre, konflikt i cili ka karakterizuar jetën shpirtërore si dhe ka përcaktuar veprimin politik e kulturor të më shumë se një përfaqësuesi të Rilindjes shqiptare.

Në këtë kuptim areali shqiptar nuk veçohet prej të ashtuajturës 'krizë e Iluminizmit': "Si elles proclament le progrès et si elles impliquent une dialectique, les Lumières ne sont cependant jamais des thèses simples et uniformes sans autre rapport que conflictuel avec ce qu'elles ne sont pas. /.../ Les Lumières n'ont pas cette naïveté confiante ou victorieuse qu'on leur prête souvent et qui les vouerait par la suite à des crises par lesquelles elles tuent ou meurent: avec les anti-Lumières dont elles ne sont jamais absolument séparées et qui ne se défont jamais véritablement d'elles, elles constituent essentiellement une crise: la crise que sont les Lumières." (Penisson: 232)

Iluminizmi shfaqet në krye të herës si provokues i lindjes, përmes krizës, pranimit e refuzimit të njëhershëm që shkakton, përmes nxitjes e njëherazi përmes mohimit të tij, të sistemit letrar kombëtar shqiptar. Është rasti i Jeronim de Radës, me të cilin përurohet (inaugurohet) epoka e letërsisë së re shqipe të Rilindjes Kombëtare.

Në asnjë tekst tjetër më shumë se në paragrafin e mëposhtëm të "Autobiologjia" (Autobiografia) të pionierit të Rilindjes Kombëtare shqiptare e të letërsisë së saj Jeronim De Rada nuk pasqyrohet shpirti i trazuar i krijuesit shqiptar të epokës së re dhe Iluminizmi njëherësh si udhëçelës e si fermentues krize.

"Leximet e shumta, ndonëse pa metodë, si përherë, e tronditën shpirtin tim që nga thellësia. Kaq mendime të një bote të krishterë (dukej se kishin pak njohuri për Krishtin) dhe filozofia franceze e shekullit XVIII vepruan kundër besimit tim të plogësht. Duke mos mundur ta dobësojnë,

më trishtuan. Nuk do të dija ta shprehja turbullimin që ndjeva një mëngjes, kur mbasi lexova në një dramë të Vernerit britmën e dëshpëruar “Krishti ka vdekur përgjithmonë”, u ngrita dhe dola nga biblioteka, i kapërthyer nga një stuhi mendimesh. Pak zinin vend tek unë fjalët e këtyre qenieve të vdekshme tokësore, por e njëjta pakujdesi imja dhe shoqëria që më rrinte përreth, që besonte në mënyrë mekanike, ishin për mua ujë i ftohtë për jetën time të brendshme.” (De Rada: 137) (Autori i përmendur, pas të gjitha gjasave duhet të jetë Zacharias Werner, nxënës i J. Jacques Rousseaux dhe i dishepujve të tij gjermanë, më tej një nga përfaqësuesit e dramaturgjisë romantike gjermane.)

Pikërisht, kjo është periudha e krizës, në zemër të së cilës Jeronim de Rada nis aksionin e vet themelues të ringjalljes kulturore dhe letrare të Shqipërisë. Mbetet të analizohen, në këtë kontekst, më në thellësi e rast pas rasti përplasjet e ideve e të rrymave të mendimit në mesin e pionierëve shqiptarë të lëvizjes kombëtare.

III.

Sa i takon pranisë së Iluminizmit dhe i raportit të tij me Romantizmin në letërsinë shqiptare të Rilindjes Kombëtare ekziston sërish një *querelle* e heshtur, e cila do të mund të emërtohej “la *geurelle*” midis bashkëjetesës sinkretike dhe periferizimit ekstrem.

Përfaqësuesi i parë e thujse i vetëm i pikëpamjes së parë, Masar Stavileci, në monografinë e tij “Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare” mbron tezën, sipas së cilës: “La littérature de la Renaissance Nationale Albanaise renferme des idées et des tendances, des traits thématiques et stylistiques de différentes époques littéraires en general, des Lumières et du Romantisme en particulier. En raison de ce rapport, nous avons considéré la littérature de cette époque (qui a vu la formation et l’éducation de la conscience nationale) comme une littérature aux idées essentiellement proches des Lumières mais dont la sensibilité et l’expression sont essentiellement propres au Romantisme. (Stavileci : 279). Më tej ai nënvizon: “Sur le plan

culturel, l’époque se distingue par l’élaboration d’une littérature artistique et le développement d’une idéologie socio-politique de tendance rationaliste et militante. C’est en ce sens que ses écrivains ont créé, pourrait-on dire, une littérature relevant tout à la fois des conceptions des Lumières et d’une sensibilité romantique. Nous considérons que ces deux conceptions – lumières et romantisme – ne s’excluent nullement, mais au contraire se complètent et s’interpénètrent dans la littérature de l’époque comme dans toute littérature où sentiment et raison coexistent. (Stavileci 1992: 282)”

Nga ana tjetër, përfaqësuesi më i madh i pikëpamjes së dytë, Rexhep Qosja, në monografinë e vet monumentale në tre vëllime “Historia e letërsisë shqiptare. Romantizmi”, megjithëse vëren se: “Struktura romantike e letërsisë shqipe të shekullit të kaluar, ndërkaq, nuk mund të quhet plotësisht e pastër në pikëpamje stilistike. /.../ “ se “Si letërsi me mision patriotik ajo do të mbështetet posaçërisht në Iluminizmin francez, që do t’i përgjigjet me ideologjinë e vet progresive dhe edukative, por, edhe në letërsinë antike greke e romake.” (Qosja 2008: 324). Pra megjithëse bën këtë vërejtje e megjithëse pohon ekzistencën e elementeve dhe të tendencave iluministe si dhe atyre klasikiste e sentimentaliste, praktikisht nuk identifikon asnjë të tillë dhe korpusin e plotë të letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, nga pikëpamja e poetikës, e tematikës, e tipologjisë së zhanreve dhe e stilit e analizon dhe e interpreton si thjesht romantike. Nëse shkolla e parë nuk arrin të sqarojë përmes analizave konkrete format e mekanizmat e realizimit të sinkretizmit ndërmjet poetikave të Les Lumières dhe romantizmit, dhe nëse shkolla e dytë nuk e identifikon po ashtu përmes analizave konkrete elementet dhe tendencat iluministe në letërsinë e Rilindjes Kombëtare, të dyja së bashku mohojnë në mënyrë implicite ekzistencën e një fenomeni letrar thjesht të Iluminizmit në këtë epokë.

Në thelb të kësaj gjendjeje ka qenë dhe është vështirësia për të parë dhe për të identifikuar te i njëjti person, tek i njëjti shkrimtar dy krijues me dy poetika të ndryshme, një poetikë romantike

dhe një poetikë iluministe, si dhe po ashtu, vështirësia për të identifikuar brenda korpusit krijues të të njëjtit shkrimtar tekste qartësisht iluministe dhe tekste qartësisht romantike. Aq më e madhe, kuptohet, vështirësia, më saktë panatyrshmëria e pranimi të simbiozës, ndërkalimit a ndërthurjes së stileve e të poetikave brenda të njëjtit tekst.

Mbetet të studiohen korpusi i teksteve të Rilindjes Kombëtare shqiptare nga kënvështrimi i poetikës dhe i veçorive tipike të stilit letrar të Iluminizmit. Gjithsesi, në gjendjen e sotme të njohjes mund të pohojmë pa mëdyshje se së paku sa i takon tipologjisë së gjinive e të llojeve, autobiografia, fabula, aforistika, poezia morale, filozofike e diturore, eseja, pamfleti shqiptar janë fryt apo produkt i Iluminizmit.

IV.

Les Lumières en Albanie un phénomène périphérique par rapport à un phénomène épacentrique (France, Angleterre, Allemagne)? On ne peut nier l'impact extraordinaires des auteurs et de grandes œuvres des Lumières d'Europe Occidentale dans l'espace littéraire et culturelle albanaise. Mais que pouvons nous dire à propos de caractère plus o moins autonome de chaque système culturel et littéraire nationaux?" (Stavileci: 321)

Entitetet sociale dhe sistemet letrare (kulturore) përgjegjëse i konceptojmë si bashkësi vetëzhvilluese me lindjen, pjekurinë e dezintegrimin e tyre. Duke qenë një i tërë organik, një i tërë vetëzhvillues, në njëfarë kuptimi një tekst i vetëm i një krijuesi të vetëm, sistemi letrar i një entiteti social, kushtëzon pjesët e tij përbërëse, lind dhe ushqen format e veta të diskursit (gjinitë, llojet, nënlojet/ drejtimet, rrymat letrare) dhe vetëm prej kësaj pikënisjeje të pashmangshme e nën këtë kushtëzim po ashtu të pashmangshëm që e tëra i bën pjesës, mban lidhje si i tërë apo si pjesë e së tërës qoftë me analogonin e vet, atë të njëmendësisë, qoftë me sistemet e tjera letrare të entiteteve të tjera sociale, të cilat, nuk mbeten të jenë veçse struktura analoge me të.

Nga perspektiva e këtij koncepti mund të formulojmë tezat e mëposhtme:

Nuk ka letërsi apo sistem letrar kombëtar të vonuar – ashtu si nuk ka entitet social (kombëtar) të vonuar, pasi përndryshe do të lindte pyetja: të vonuar, mirë por në raport me çka, me cilën pikë kohësore universale dhe kush a ç'fuqi e përcaktoi këtë? Mund e duhet të thuhet ndërkaq se po, *ka letërsi a sisteme letrare kombëtare më shumë a më pak të mëvonshëm*. Të mëvonshëm në raport me çka? Të mëvonshëm në raport me sisteme të tjera letrare kombëtare. Çdo letërsi, çdo sistem letrar kombëtar është, pra, në kohë, në kohën e vet, krijues i kohës së vet.

1. *Çdo sistem letrar kombëtar* sado i vogël, sado periferik qoftë është i plotë dhe *përfaqëson një dukuri analoge me sistemet e tjera letrare kombëtare*, qoftë në vështrim të tipologjisë së përgjithshme, qoftë të strukturës, qoftë të dukurive përbërëse, qoftë të kronologjisë së shfaqjes së tyre, qoftë të ligësorive që përcaktojnë sjelljet e kahjet e evoluimit të tij të përgjithshëm.

2. Pikërisht është kjo analogji fundamentale ajo që i jep të drejtën studiuesit të letërsisë *t'i trajtojë sistemet letrare kombëtare si dukuri të bashkëmatshme* mes tyre. Kuptohet se bëhet fjalë për një analogji-kuadër, pasi matrica bazë, gjeneruese e çdo sistem letrar kombëtar ka elemente specifike që e bëjnë analogjinë jo vetëm relative, por herë-herë të pjesshme dhe shpesh jashtëzakonisht të vështira për t'u diktuar. (Jorgo: 794-795)

V.

Nuk është marrë në shqyrtim ndikimi i metodës krijuese, i poetikës dhe i stilit letrar të Iluminizmit, thënë ndryshë fati i modeleve dhe i normave letrare iluministe në traditën letrare shqiptare të pasrindjes kombëtare. Ne mund të themi shkurtimisht se krijimtaria e të paktën tre shkrimtarëve të mëdhenj shqiptarë të shekullit XX ka pikëtakime të forta me frymën, poetikën, modelet e stilit iluminist: proza e gjatë e Faik Konicës, në veçanti novela "Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit", poema e lasgush Poradecit "Ekskursioni teologjik i Sokratit" si dhe një pjesë e krijimtarisë në poezi e prozë e Millosh Gjergj Nikollës.

Nga letërkëmbimi i Migjenit sjellim këtë dëshmi: “Në vitet e fundit letërsia jonë është shumë e njëanshme dhe këtu është me vend të kujtojmë “Etydin mbi Bejlin” të Balzakut. Ai e shikon letërsinë e Rilindjes si “letërsinë e ideve”, kurse Romantizmin si “letërsinë e figurave”. Letërsia jonë tani është ekstremi më i keq i njëjës dhe i tjetrës. Ose ka shumë figura, ndërsa idetë nuk duken, ose ka ide pa art.

Pse ne të mos i bashkojmë të gjitha këto, duke marrë nga iluministët francezë pjesëmarrjen aktive të autorit në veprimet, në mënyrë që ai të hapë përpara lexuesve perspektiva të mëdha, perspektiva të cilat, kuptohet) i lejon vetëm situata e dhënë e subjekteve. Sa e mirë është p.sh. “*Kjo nuk është përrallë*” e Deni Diderosë. Nuk e di për të tjerët, por unë personalisht do ta konsideroja veten nxënës të francezëve.” (Migjeni: 137)

Përfundime

Një interes dhe studim të posaçëm do të meritohte fakti i përkthimeve relativisht të kufizuara dhe të vonuara, shpesh jo integrale, të korpusit të veprave themelore të Lumieres në shqip. Po ashtu fakti i diskrepancës ndërmjet receptimit krijues të teksteve iluministe nga shkrimtarët dhe i receptimit nga ana e kritikës e publikut në përgjithësi. Shkrimet kritike dhe korpusi i parateksteve shoqëruese të përkthimeve është modest. Kryesisht jepen të dhëna të përgjithshme mbi jetën e veprën e autorëve, por mungojnë analizat e thelluara të koncepteve të tyre. Jo të

pakta janë veprat e përkthyer të iluminizmit, të cilat – aspak e zakontë kjo në traditën e editorisë shqiptare – nuk shoqërohen me parathënie. Cilat janë arsyt e një dukurie të tillë? Veç të tjerash natyra akoma subversive e një pjese të projektit iluminist për shoqëri totalitare apo që ndodhen në rrugën e demokratizimit. Moderniteti, ende i paezauruar plotësisht i poetikës së tij?

Do të na pëlqente ta pohonim këtë duke përfunduar: deviza e Iluminizmit, shprehur në mënyrë magjistrale nga Kanti “Sapere aude! Aie le courage de te servir de ton propre entendement. Voilà la devise des Lumières.” si dhe gjithë projekti i Iluminizmit do të vijojnë të jetë për një kohë të gjatë urdhër dite në shoqërinë, në kulturën e në shkencën shqiptare.

Bibliografia

- AA.NN. Fjalori Enciklopedik Shqiptar (2009), vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
 DE RADA, Jeronim (2005), Autobiologjia. Përktheu nga italishtja prof. Alfred Uçi, Toena, Tiranë.
 JORGO, Kristaq (2010), Mbi studimin e evolucionit historik të ssiteimit letrar: koncepte, vëzhgime, teza, shembullzim: AKTET, vëll. III, Nr. 5, 2009, Tiranë – Prishtinë-Shkup.
 QOSJA, Rexhep (2008), Romantizmi, Toena, Tiranë.
 STAVILECI, Masar (1992), Iluminizmi në kulturën dhe në letërsinë shqiptare, Rilindja, Prishtinë.